



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS

Saranda mirëpret edicionin e Katërt të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit DEA OPEN AIR

2017-08-27 12:35:00



Nga datat 27 Gusht deri më 2 Shtator 2017, vazhdon të zhvillohet Festivali Ndërkombëtar i Filmit Dea Open Air që zhvillon edicionin e tij të katërt. Nga datat 27 Gusht deri më 2 Shtator 2017, vazhdon të zhvillohet Festivali Ndërkombëtar i Filmit Dea Open Air që zhvillon edicionin e tij të katërt. Festivali vijon traditën e të qenit vizitor në stolinë e rivierës shqiptare, Sarandë. Shfaqjet Open Air janë organizuar në Kinema Limani dhe Kinema Bougainville. Në Kinema Limani u zhvillua ceremonia zyrtare e Hapjes së Edicionit IV të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit Dea Open Air Sarandë – 2017 ndërsa u prezantuan dhe dy programet kryesore të festivalit: programi i Filmit me Metrazh të Gjatë dhe programi i Filmit të Shkurtër. Në Kinema Bougainville është organizuar për herë të parë programi “Miqte e Kinemasë”, me shfaqje speciale filmash jashtë konkurimit si edhe Ceremonia e Ndarjes së Çmimeve të Edicionit IV të Dea Open Air Festival Sarandë – 2017.

Numri i aplikantëve të DEA OPEN AIR ka ardhur në rritje nga viti në vit. Edhe edicioni i sivjetëm konfirmon të njëjtën tendencë rritëse. Të gjithë aplikuesit dhe pjesëmarrësit e përzgjedhur kanë aplikuar në platformat Film Freeway dhe Feshome ose në rrugë të drejtpërdrejtë në adresën e Festivalit. Ata vijnë jo vetëm nga vendet evropiane, por edhe më gjerë, çka i jep pjesëmarrjes një gjeografi ndërkontinentale. Filmat e paraqitur dhe autorët pjesëmarrës në konkurim i janë nënshtruar fillimisht seleksionimit paraprak të komisioneve ndërkombëtare, të mbyllur në fund të muajit Mars. Në garë për Çmimet DEA komisionet e përzgjedhjes paraprake kanë menduar të përfshijnë sivjet 6 filma të gjatë për **Seksionin e filmit me metrazh të plotë** ose konkurimin kryesor si dhe 35 filma në **Seksionin e filmit të shkurtër**. Vetë filmi i shkurtër ofrohet këtë vit në dy nënkategori: konkurim ndërkombëtar dhe konkurim studentor. Kategorizimi reflekton natyrën e krijimtarisë dhe profilin e autorëve të tyre. Programi special “**Miqte e Kinemasë**” do të ofrojë edhe 6 filma të tjerë me metrazh të plotë, ku përfshihen tituj të përzgjedhur filmash, të prodhuar nga autorë të huaj dhe vendas. Sipas traditës edhe në këtë edicion konkurimi do të ndiqet nga disa juri, të përbëra me personalitete të njohura të kulturës, kinemasë dhe medias në rajon dhe më gjerë:

Juria e filmit me metrazh të gjatë, e përbërë nga: Veton Surroi (shkrimtar dhe publicist - Kosovë), Dr. Cathy de Haan (studjuese e filmit dhe komunikimit - Gjermani), Mevlan Shanaj (regjisor - Shqipëri), Diana Dobрева (aktore dhe regjisore – Bullgari), Agron Vula (regjisor dhe producent – Kosovë) do të ndjekë programin e filmit me metrazh të gjatë si edhe do të akordojë çmimet DEA për: Aktorin/Aktoren më të mirë në rol kryesor ; Fotografinë/Kameran më të mirë; Skenarin më të mirë, Regjinë më të mirë dhe Filmin më të mirë në konkurimin e filmit të gjatë. Kjo juri ndan çdo vit edhe

Çmimin Special të destinuar për kontribute të spikatura të artistësh të rinj me karrierë premtuese në kinematografi.

Juria e filmit të shkurtër, e përbërë nga: Natasha Lako (poete dhe skenariste); Ema Andrea (aktore) dhe Sokol Krasniqi (grafist) do të ndjekë programin e filmit me metrazh të shkurtër si edhe do të akordojë çmimet DEA për: Montazhin më të mirë, Regjinë më të mirë, Filmin e shkurtër më të mirë si edhe dy çmime, që ndahen nga partnerët mediatikë të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit DEA OPEN AIR : DEA për Angazhim qytetar (Çmimi i TV Klan) dhe DEA për Idenë më të spikatur (Çmimi i RTV 21 - Kosovë)

Juria e medias, e përbërë nga: Astrit Idrizi (regjisor dhe producent), Violeta Murati dhe Shpresa Dine – gazetare. Sfidë e Edicionit të Katërt të DEA OPEN AIR mbetet afrimi i audiencave me filmin. Për këtë qëllim krahas promovimit të aktivitetit dhe produktit filmik në qytet dhe në media, DEA në bashkëpunim me Neptun Saranda do të organizojë dhe një llotari, në fund të të cilit do ndahet sivjet Çmimi i publikut. Pjesëtarët e publikut do të pajisen në hyrje të kinemasë me një formular vlerësimi për filmin, të cilin do ta dorëzojnë kur të largohen. Formularët e mbledhur do të shërbejnë si bileta për llotarinë dhe si bazë vlerësimi për Çmimin e publikut.

Edicionin e Katërt të DEA International Film Festival e mbështet Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë, të cilat së bashku me Bashkinë e Sarandës krijojnë atmosferën e nevojshme mikpritëse për prurjet artistike dhe kontributet qytetare nga e gjithë bota. Specialistët e kinemasë, drejtorët e disa festivaleve të tjera evropiane të filmit, por dhe aktorët, regjisorët, producentët dhe gazetarët e ftuar i japin aktivitetit gjallërinë dhe komunikimin shumëdimensional, që kinemaja gjithnjë premtan dhe realizon.